



---

## BASHKIA SKRAPAR

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbrojtje ure mbi lumin e Tomorricës, krahu i majtë dhe krahu i djathtë në hyrje dhe dalje**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45243510-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 52 462 565** (pesëdhjetë e dymilion e katërqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1*

d. *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2 (volumet e punimeve janë dhënë bashkëlidhur dokumenteve të tenderit)*

e. *Grafikun e punimeve të konfirmuar nga ofertuesi (grafiku është dhënë bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Ofertuesi mund të paraqesë një grafik punimesh të personalizuar, por afati i punimeve nuk mund të jetë më i madh se ai i parashikuar nga autoriteti kontraktor).*

**Argumentimi:** Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3; për pikat c. d. dhe e. - në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

---

neni 39 pika ç, si dhe seksionit III, neni 39, pika 3. ku përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të objektit të prokurimit.

*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për dy vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

*Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Shënim:** Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës

---

kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 39, 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimi e vlerëson te nevojshme kriterin për xhiron mesatare, dorëzimin e dokumentit përkatës vërtetim ose pasqyrat financiare vjetore, pasi vërtetojnë kapacitetet ekonomike, financiare të operatorit ekonomik me qëllim përmbushjen dhe realizimin e kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomike dhe të mundësisë se tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

**2.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023, si dhe për këstet e maturuara të detyrimeve për vitin 2024.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së

**Shënim :** *Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023, si dhe për këstet e maturuara të detyrimeve për vitin 2024, duke listuar vendet ku kanë ushtruar aktivitet si dhe vlerën e detyrimit të paguar për secilin vend.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me deklarin e tij në formularin e vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

**Argumentimi:** Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik, në përputhje me kuadrin ligjor për taksat dhe tarifave vendore

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon:

- vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, (Formular vlerësimi sipas shtojcës 9)
- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
- Procesverbalin e kolaudimit (për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve)

***Shënim:** Formulari i vlerësimit në rastin e punës së ngjashme të kryer nga BOE duhet të tregojë saktësisht % e ndarjes së punës midis OE. Paraqitja e një formulari të plotësuar jo sipas formatit zyrtar, do të kosiderohet kusht për mos njohjen e punës respektive.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi:

- vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, lëshuar nga subjekti privat
  - kontratë sipërmarrje.
  - fatura tatimore e situacionit përfundimtar
  - situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
  - procesverbalin e kolaudimit (për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve)
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar, për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.
-

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

### **2.3.2. Licenca profesionale**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

#### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

- N.P – 1 A** Punime gërmimi në tokë
- N.P – 4 A** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- N.P – 9 C** Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime

#### **PUNIME SPECIALE NË NDËRTIM**

- N.S - 18 B** Punime topogjeodezike

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit, që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane..", VKM-së nr.759/2014 "Për licencimin

---

profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr.10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar, si dhe në përputhje me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve. Në grafikun e punimeve që jepet bashkëlidhur janë argumentuar licencat e kërkuara.

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

### **2.3.3. Staf dhe punonjësit**

A) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- |  |         |
|--|---------|
| – Inxhinier Ndërtimi (profili strukturist) | 1 (një) |
| – Inxhinier Hidroteknik                    | 1 (një) |
| – Inxhinier Gjeodet                        | 1 (një) |

Si dhe inxhinierët, staf mbështetës, **jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- |                     |         |
|---------------------|---------|
| – Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |
| – Inxhinier Mekanik | 1 (një) |

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune individuale, të vlefshme
- Licencën profesionale
- Listpagesën shoqërisë e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave ku punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë sipas kodit përkatës të profesionit.

### **Shënim:**

- Drejtuesit Teknik në licencë, duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
  - Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.
  - Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga Administratori i shoqërisë, Përgjegjës/Drejtuesin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi
-

Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çdo anëtar i grupit duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik dhe stafin mbështetës inxhinier, sipas zërave të preventivit, që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë.

**B) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar:**

### **I. Punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë**

– Teknik Ndërtimi	2 (dy)
– Punues guri dhe muratorë	10 (dhjetë)
– Saldator	1 (një)
– Hekurkthyes	3 (tre)
– Karpentier	3 (tre)
– Mekanik	1 (një)

Për specialistët e kërkuar më sipër ( pika 2.5.2 gërma a ) të paraqiten:

- diplomë/ dëshmi/ certifikatë/ ose çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tyre
- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve,
- të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, të paktën, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Shënim:** Gjatë fazës së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pikën B. - Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomikë për punonjësit e mësipërm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punës, subjektin lëshues të certifikatës/diplomës, Nipt (në rastin kur subjekti lëshues i certifikatës/diplomës është privat).

*Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumente të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.*

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8***

### **II. Drejtuesit e automjeteve dhe automakinistët**

- **Drejtues i makinerive të rënda të ndërtimit**, (të paisur me Certifikatë Aftësi Profesionale për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit dhe Punimeve në Tokë nga DPSHTRR) **4 (katër)**

- **Eskavatorist** (i paisur me Certifikatë Aftësimi Profesional për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit dhe Punimeve në Tokë nga DPSHTRR). 3 (tre)
- **Drejtues kamioni (autokamionist)** me Leje drejtimi të **tipi C** si dhe të pajisur me Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR 6 (gjashtë)

Për drejtuesit e automjeteve dhe automakinistët, (pika 2.5.2 gërma b) të kërkuar më sipër të paraqiten:

- kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve,
- Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR sipas kategorisë përkatëse
- leje drejtimi kategoria C për drejtuesit e automjeteve
- të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Shënim:** Gjatë fazës së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoristë/manovratorë, automakinistë dhe shofer, **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmërisë së saj.

**Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, dhe të cilët kanë vënë në dispozicion dhe drejtuesit e tyre egzistues, atëherë manovratorët, automakinistët dhe shoferët, për këto mjete, kërkohet që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues nga momenti i lidhjes së kontratës së qerasë.**

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

- III.** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një numër, të paktën, prej **76 (shtatëdhjetë e gjashtë)** punonjësish në fushën e ndërtimit, përveç stafit drejtues dhe inxhinierëve të kërkuar në pikën 2.5.1, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku punojësit e mësipërm të figurojnë sipas kodit përkatës të profesionit.

**Argumentimi:** Për pikat (A,B,C) kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, pika 6, shkronja c dhe ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku ky kriter lidhet ngushtësisht me objektin të kontratës *si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve*. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri një i inxhinierëve sipas profilit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në kryerjen e punimeve, duke ju referuar objektit, vendndodhjes gjeografike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast mund



të çojë në mosrealizim në afat dhe me cilësi të dobët të punimeve. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm për realizimin kontratës.

**IV.** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar/çertifikuar, si dhe të figurojnë në listpagesa për tre muajt e fundit, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës që të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
- 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga një organ i akredituar për dhënien e Ndihmës së Parë.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8***

**Argumentimi:** Në mbështetje të ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM-në Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”, si dhe Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, kreu III. “Shërbimi i brendshëm për parandalimin dhe mbrojtjen në punë”, pika 4 ku përcaktohet: 4. Aftësitë në lidhje me sigurinë, mjekësinë e punës dhe aspektet psikosociale të punës, në asnjë rast, nuk mund të ushtrohen nga një person i vetëm.

#### **2.3.4. Mjetet dhe paisjet**

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe pasijet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

Nr.	Paisje e makineri	Njësia	Sasia	Pronësia
1	Çekiç për coptim guri	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me zinxhir 0.25m <sup>3</sup>	copë	3	Në pronësi ose me qera
3	Betoniere kantieri 500l	copë	4	Në pronësi ose me qera
4	Vibrator betoni	copë	4	Në pronësi ose me qera
5	Kallëp themele e mure me dërrasa të veçuara (betonforma)	m <sup>2</sup>	300	Në pronësi ose me qera
6	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Motopompë uji	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Fadromë me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera

10	Minieskavatorë	copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Dumper	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Kthyese hekuri (Bango hekuri)	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Kamionë vetshkarkues me kapacitet mbi 10 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
14	Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton.	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Kamionë vetshkarkues me kapacitet mbi 20 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
16	Autovinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Rul ngjeshës me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Saldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Transportier për mjete të rënda	copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
23	G.P.S ose Total Station (gjeodezik)	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Karroca dore	copë	10	Në pronësi ose me qera
25	Kokore për punonjësit	copë	84	Në pronësi ose me qera
26	Jelekë për punonjësit	copë	84	Në pronësi ose me qera
27	Komplet i ndihmës së shpejtë	copë	5	Në pronësi ose me qera

(a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, (çertifikata e pronësisë);
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit);
- çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- leje transporti e vlefshme nga pushteti vendor (sipas rastit)
- foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;

- (b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
- kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse
  - fotot
- (d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

### **Shënim:**

Në rastin kur fatura tatimore është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, ajo duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

- (e) Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim, që nëse kërkohet, të verifikimit nga Autoriteti Kontraktor.

**\*Kujdes:** Gjatë fazës së ofertimit, bashkë me deklaratën sipas pikës e) më lartë, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), *Tabela e mjeteve sipas pikës C “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, duhet të plotësohet saktë me të gjitha të dhënat. Mjetet që nuk i kanë të gjitha të dhënat sipas tabelës, nuk do të merren në konsideratë. Dokumentet e kërkuara më sipër në pikat a),b),c),d) do të kërkohen ofertuesit i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për përjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.**

**Argumentimi:** Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, pika 6, shkronja d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri është në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve. Gjithashtu është në përputhje me natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës. Operatorët ekonomik kërkesat për pajisje në pronësi, mund të plotësojnë edhe duke i marrë ato me qira. Lidhur me paisjet Autoriteti Kontraktor ka patur parasysh projektin, preventivin dhe relacionin teknik. Këto pajisje mund të sigurohen lehtësisht nga operatori ekonomik pasi janë me kosto relativisht të ulët dhe nuk përbëjnë kriter diskriminues.

### **2.3.5. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve**

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë **ose ekuivalente me to**:

- Certifikate ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)
- Certifikate ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)
- Certifikatë ISO 45001–2018 (Shëndetin dhe Sigurimin në punë)

*Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.**

**Argumentimi:** Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të punimeve duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë.Gjithashtu AK kërkon garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, konform ligjeve dhe politikave të vendit tonë. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

*Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet të jene te leshuar nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoje keto certifikata ne perputhje me sherbimet qe ka marre persiper në marreveshjen e bashkepunimit.*

### **2.3.6. Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces**

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin një vetëdeklarim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, që operatori ekonomik brenda së njëjtës **periudhë** është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, apo në pritje për tu lidhur. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

### **DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS**

*(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)*

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se brenda të njëjtës periudhë, jam kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, apo në pritje për tu lidhur për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

**Kujdes: Deklarata e mësipërme duhet të dorëzohet gjatë fazës së ofertimit. Mungesa e deklaratës është kusht s’kualifikimi.**

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës që dorëzojnë deklaratën, nga e cila vërtetohet se ai, për të njëjtën periudhë, është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, apo në pritje për tu lidhur, me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti, sipas kategorive në licencën profesionale, do të skualifikohen.

**Argumentimi: Në zbatim të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, kreu III, “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet”, pika 1 gërma b), ku përcaktohet:**

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence

### **3. TË PËRGJITHSHME**

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklaramit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Specifikimet Teknike**

Objekti i prokurimit: **“Mbrojtje Ure mbi lumin e Tomorricës, krahu i majtë dhe i djathtë, në hyrje dhe në dalje”**, shoqërohet me projekt zbatimi të plotë, relacion teknik, specifikime teknike, grafik punimesh dhe preventiv punimesh.

Projekti i hartuar nga “G&L CONSTRUCTION”, i është nënshtruar edhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit, i cili ka miratuar projektin e zbatimit, relacionin teknik, specifikimet teknike, grafikun e punimeve dhe preventivin e punimeve, me shkresën nr.506/2 prot. date 31.05.2024.

Për pasojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Specifikimet teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte te Tenderit, për procedurën e hapur, punë.

### **Përfundime**

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte te Tenderit, për procedurën e hapur, punë me objekt prokurimi **“Mbrojtje Ure mbi lumin e Tomorricës, krahu i majtë dhe i djathtë, në hyrje dhe në dalje”**.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**Altin Lamçe**

**Ernest Ymeri**

**Jona Koçi**

---